Arkivo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

PROCES-VERBAL

Nr. 7019 **Prot.** **Lushnje, më** 15/08/2025

Mbajtësi i proces verbalit: Denisa Gjyshja SNL Arkivë
Emër **Mbiemër** **Funksioni**

Të dhëna të përgjithshme

Konsultim publik mbi: Planin strategjik për Menaxhimin e pyjeve

Data e takimit: **15.08.2025**

Ora e takimit: **10:00**

Vendi i takimit: **Muzeu Historik**

Kryesuesi i takimit: Z/Znj. Erion Hasani

Këshilltarë bashkiakë në takim: 1._____ ; 2._____

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim: _____

Anëtarë të strukturave komunitare: _____

Pjesëmarrës nga komuniteti: Nr____ persona, Femra _____, Meshkuj _____

Të rinj _____, Biznesi _____.

Hap këtë dëgjesë publike mbi "Planin Strategjik të Menaxhimit të Pyjeve" z. Erjon Hasani Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.

Mbarështimi i pyjeve është planifikim afatgjatë për fondin pyjor, në rastin konkret është bërë në bazë të kritereve të caktuara për grumbullimin e informacionit dhe për përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, me qyrim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale

- Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe shullotave është:

Rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afatshkurtra dhe afatgjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjorë.

Në objektivat e këtij plani një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar "Sigurimi i një mbrojtjeje të qëndrueshme dhe shumë funksional i pyjeve".

- Objektivat kryesore janë

1- Sigurimi i normalitetit në grembyjt pyjorë
2- Vlerësimi i pyllit si ekosistem multifunksional për ruajtjen e biodiversitetit
3- Intensifikimi i rritjes natyrore të grembyjve pyjo
4- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i ripërtëritjes natyrore.
5- Përmirësimi i përbërjes së llojeve fletore+halore
6- Rritja e cilësisë së kërcellit dhe e kurorës së drur
7- Përmirësimi i mënyrës i infrastrukturës rrugore
8- Përpjekja maksimale për kontrollin e erozionit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.
9- Vlerësimi i mundësisë prodhuese të produkteve jodrusore pyjore dhe zbatimi i praktikave mirëmenaxhuese të vjeljes së tyre.

Adresa:Lagjja "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

(10)- Të krijojë mundësi për zhvillimin e turizmit natyrorë dhe rurale

- Fletë z. Nuri Senka (Punonjës i Njësisë Administrative Karbunarë)
Çfarë masash janë marrë për mbrojtjen e pyjeve në rast zjarri?
- Përgjigjet z. Erion Hasani
Në si sektorë kemi ngritur pika vrojtimi. Në zonat më të rrezikuara i kemi intensifikuar ato. Plus kemi bërë marrveshje si me Bizneset dhe me Zjarrëfikësen për gatishmëri dhe ndihmë të menjëhershme në shuarjen e zjarreve.
- Flet Antoni i Këshillit
- A mund të ngrihen grupe vrojtimi 24 orë?
- Përgjigjet z. Erion Hasani. Po mundet dhe

i kemi ngritur këto grupe që të na vinë në ndihmë në çdo kohë. Plus ne si Sektor jemi në gadishmëri 24orë.

- Fletë Qytetarja Dëgjojmë shpesh nëpër televizione për zjarret në këtë periudhë A mund të më thoni çfarë masash jan marrë për Zonën e Ballagatit e cila është kryesisht zonë pyjore, por mbi të gjitha është zonë e thellë dhe jo shumë e aksesueshme
- Fletë znj. Anila Çela ku shpjegon që gadishmëria nga çdo kush nga ne është e menjëhershme dhe ne po i shkojmë në ndihmë edhe qytetëve të tjerë

Mbyll këtë dëgjesë publike z. Erion Hasani duke falenderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen

Mbajtëse e procesverbalit
Denisa Gjyshja.